LIBRI “CHARLES TELFORD ERICKSON” NË TRE VOLUME I MAL BERISHËS, NË BIBLOTEKËN E KONGRESIT AMERIKAN



WASHINGTON D.C: Mbas promovimit në kuadër të aktiviteteve për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, të librit "Charles Telford Erickson", me autor Mal Berishën, dhe daljes në qarkullim të këtij libri interesimi dhe jehona që ka pas ky libër ka qenë jashtëzakonisht i madh në mesin e lexuesve brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Bibloteka e Kongresit, librin "Charles Telford Erickson", me autor Mal Berishën. e ka futur vet pa ndonjë "ndërhyrje" ne raftin e parë të pavionit të librit, dhe e ka ekspozuar me anë të një posteri në hyrje të kësaj bibloteke e cila çdo ditë vizitohet nga mijëra amerikan dhe turistë të huaj, përfshirë kongresmen, senatorë dhe poliitikan e shkrimtarë e artistë të mëdhenjë amerikan.

Libri "Charles Telford Erickson", gjendet edhe në Dhomën e Referencave në Bibliotekën e Kongresit ne Washington DC, e cila shfrytëzohet për studime, kërkime dhe hulumtime, nga njerë qëduan të dinë më shumë rreth këtyre librave që gjenden në Dhomën e Referencave në Bibliotekën e Kongresit ne Washington DC, të cilat numërojnë mbi një mijëtituj dhe autor të ndryshëm nga mbarë bota.

Ndërkohë, mbrëmë, u transmetua edhe nga Top Channel emisioni Vitrina e librit, 17 Mars – një intervistë e plotë e Mal Berishës autorit të librit "Charles Telford Erickson", me gazetaren Beti Njuma – Intervisten e ndiqni ne youtube : (http://www.youtube.com/watch?feature=player_embedded&v=DIzpQhrEtNE)

Libri Charles Telford Erickson, jeta dhe vepra për Shqipërinë dhe në Shqipëri, nga Mal Berisha, gjendet tash në të gjitha biblotekat e Shqipërisë e Kosovës, si dhe pikat e shitjes dhe përhapjes së librit. Ky është një vëllim që përfshin veprën me dy vëllime "Shqiptarët, enigma e Ballkanit" të Charles Telford Erickson dhe "Jeta e jashtëzakonshme e amerikanit Charles Telford Erickson kushtuar Shqipërisë", shkruar nga shkrimtari, publicisti dhe studuesi Mal Berisha, ambasador i Shqipërisë në Londër.

Shtëpia e Librit :

Charles Telford Erickson, jeta dhe vepra për Shqipërinë dhe në Shqipëri (kopertinë e trashë, lidhje luksoze)
Origjinali: Charles Telford Erickson, jeta dhe vepra për Shqipërinë dhe në Shqipëri (kopertinë e trashë, lidhje luksoze)
Gjinia: Biografi, histori
Përgatiti: Mal Berisha
Shtëpia botuese: Edualba
Viti: 2012
Fq. 1040
Pesha: 2.02 kg
ISBN: 978-9928-12-157-8

Mbi librin

Në prag të 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Mal Berisha vjen para lexuesit shqiptar me një vepër të re mjaft interesante rreth jetës dhe veprës së amerikanit Charles Telford Erickson. Pas botimit të dy veprave pararendëse me subjekte të përafërta: "Shqiptarët, lisa mbi truallin ilir" dhe "Shqiptarët, europianët më të lashtë e më të rinj", ky libër duket se plotëson tanimë një seri e cila fillon me fjalën "Shqiptarët..."për të shprehur me fjalë njerëzish të mëdhenj, jo shqiptarë, vlerësimin për kombin tonë. Këto vlerësime mund të thuhet lirisht se kulmojnë me këtë vepër.

Ky vëllim përfshin veprën me dy vëllime "Shqiptarët, enigma e Ballkanit" të Charles Telford Erickson dhe "Jeta e jashtëzakonshme e amerikanit Charles Telford Erickson kushtuar Shqipërisë" të Mal Berishës.

Komente mbi Charles Telford Erickson

"Përkundër rrjedhës së gjatë dhe të mundimshme të historisë së saj, Shqipëria ka patur fatin të ketë miq të mëdhenj, të cilët i kanë kushtuar jetën, midis të cilës prin amerikani Charles Telford Erickson."

Dr. Elez Biberaj

“Janë pak ato jo shqiptarë, nëse ka ndonjë që mund të maten për nga kohëzgjatja dhe kontributi në shërbimin ndaj Shqipërisë me Charles Telford Erickson. Nxjerrja në dritë pas një harrese shumë të gjatë të veprës së tij është shenjë e mirënjohjes shqiptare për këtë mik të madh.”

Nicholas C. Pano, professor emeritues i historisë, Western Illinois University

“Charles Telford Erickson përfaqëson një qytetar amerikan me zemër shqiptare, nga më të mëdhatë e gjysmës së parë të shek. XX – të. Veprat e tij do mbeten episode të rëndësishme, të shkëlqyera dhe të paharruara në historinë e vendit tonë.”

At Arthur Liolin, Boston

“Erickson jetoi gjatë në Shqipëri, u magjeps pas saj dhe i la trashëgim një vepër monumentale. Shqiptarët, në kthim të dashurisë së tij, në këtë 100 vjetor të pavarësisë dhe të shtetit tonë modern, sjellin në shqip biografinë dhe veprën e tij të jashtëzakonshme.”

Visar Zhiti, shkrimtar

“Ky botim i mrekullueshëm zbulon një figurë sa modeste, aq edhe madhështore dhe e nxjerr atë përgjithmonë nga pluhuri i harresës.”

Ilir Ikonomi, historian

“Kjo vepër na ndihmon të kuptojmë veç të tjerash edhe kontributin e Federatës Panshqiptare “Vatra” të Amerikës në çimentimin e themeleve të shtetit shqiptar në këtë jubile të 100 vjetorit.”

Dr. Gjon Buçaj, kryetar i Federatës Panshqiptare “Vatra”, New York